# Sektori i Agro-përpunimit
## Për një Treg Pune në Dobi të Rinisë Shqiptare

RisiAlbania
Partner për Zhvillim

Sektori i agro-përpunimit (AP), i përbërë kryesisht nga biznese të vogla dhe të mesme, aktualisht, mbulon 5% të PBB në Shqipëri. Ky sektor ka një potencial të konsiderueshëm për rritje dhe tanimë ka punësuar më shumë se 11,000 persona në vende formale pune dhe shumë më tepër në punë sezonale. Dy të tretat e krahut të punës në kete sektor janë nën 30 vjeç, nga të cilët 70% femra. Ndërhyrja e Projektit RisiAlbania në këtë sektor synon të mbështesë rritjen e agro-përpunuesve, me qëllim krijimin e më shumë vendeve të punës për të rinjtë dhe të rejat. Kjo do të arrihet përmes:

- Zhvillimit të shërbimeve cilësore të biznesit, veçanërisht në marketim;
- Mbështetjes së sektorit bankar për produkte financiare më të mira për agro-përpunuesit;
- Rritjes së mëtejshme të Investimeve të Huaja Direkte në sektorin e agro-përpunimit;
- Rritjes së kapacitetit te aktoreve kryesorë në përmirësimin e mjedisit të biznesit të tyre.

## Fushat e Ndërhyrjes së RisiAlbania

### Shërbimet e Marketimit dhe të Biznesit

Në partneritet me Shoqatën Shqiptare të Marketimit dhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, janë fuqizuar kapacitetet e ofruesve të shërbimeve të biznesit në sektorin e AP për të ofruar shërbime më të mira profesionale marketimi si edhe shërbime të tjera teknike. Kjo siguron adresimin e nevojave të ndryshme, duke përfshirë strategjitë e marketimit, zhvillimin e produktit, paketimin, etiketimin, brandimin dhe aksesin në tregjet ndërkombëtare.

Për të përfituar nga potenciali në rritje i tregut organik, projekti po mbështet Albinspektin, i vetmi certifikues organik i akreditуar në Shqipëri, për të ofruar shërbimet e para-inspektimit dhe të informacionit për agro-përpunuesit, duke nxitur në këtë mënyrë rikthimin e produkteve organike.

### Më shumë lehtësira për kredimarrjen

Përsa i përket mundësisë së financimit, RisiAlbania po mbështet zhvillimin e një sistemi për informacionin e tregut i cili do të bëjë të mundur që bankat të kryejnë vlerësime të sakta të rriskut dhe të modifikojnë produktet dhe procedurat e huave, duke ju ofruar agro-përpunuesve afate dhe kushte më të favorshme te huadhënies.

### Një mjedis më i favorshëm biznesi

Në bashkëpunim me aktorët e industrisë agro-perpunuese RisiAlbania synon ngritjen e kapaciteteve dhe të mekanizmave të përshtatshëm për të përkrahur skemat e mbështetjes dhe për çështje të tjera që lidhen me sektorin për një mjedis më të mirë biznesi dhe rritje të investimeve.